



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:279546

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06585336

C.nr.1413/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.Sh nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat F.N nga Shtime, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF- Rahovec, baza juridike: *Kompensimi i pagës së 13-të*, vlera e kontestit: 1,508.00 euro, jashtë seancës, me datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi që paditëses A.Sh nga Rahoveci, t'ia paguajë pagën e 13-të, në lartësi prej një page bazë në shumën 377.00 euro, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, në shumën e tërësishme prej 1,508.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë), si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja A.Sh nga Rahoveci, përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur padi kundër të paditurës, të precizuar me parashtrësën e datës 18.09.2024, me objekt kontesti: *Kompensimi i pagës 13-të*, vlera e kontestit: 1,508.00 euro, duke përshkruar gjendjen faktike si në vijim: Parashtruesja e kësaj padie është e punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec, në pozitën e Infermieres. Kjo dëshmohet edhe me kopjet e bashkangjitura të kësaj padie. Sipas Kontratës Kolektive Sektoriale, bazuar në nenin 17 par. 2 parashihet se punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13-të, për çdo vite kalendarik, në lartësinë e pagës bazë, dhe atë sipas mundësisë buxhetore të punëdhënësit. E paditura duke pasur mundësi buxhetore për çdo vite asnjëherë vullnetarisht nuk iu ka bërë kompensimin nga miratimi i kësaj kontrate. Andaj, paditëses i takon paga e 13-të për vite 2018,2019,2020 dhe 2021. Gjykatës i propozoi gjykatës që pas analizimit të të gjitha fakteve dhe provave kërkesëpadinë e paditëses të e aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigje në padi të datës 11.11.2024, ka theksuar se: E kontestojmë në tërësi si të pa bazuar dhe të pathemeltë kërkesëpadinë e paditëses, meqenëse paditësja nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), respektivisht i mungojnë mjetet financiare për të kryer pagesat e pagës së 13-të. Me tej ka shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj, nga të lartcekurat i propozojë gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës dhe të administrimit të provave të marr aktgjykimi refuzues.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, e ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse ishte e punësuar tek e paditura dhe se gëzonin shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestues ishte baza e kërkesëpadisë, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara.

Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit 48/2015, e lidhur në mes të Komuna Rahovec- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF- Rahovec, në cilësi të punëdhënësit dhe A.Sh në cilësi të punëmarrësit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar duke filluar nga data 01.01.2015, dhe gëzon shpërblimin në pagën bazë prej 362.50 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se “*Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*”.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka

mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. (*Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023*).

Sipas Ligjit nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Rahovecit ka qenë 7,296.623 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se *shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve "Mallra e shërbime" nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat*. Në anën tjetër, sipas raportit auditimit për komunën e Rahovecit për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 7,259,001 euro ndërsa realizimi për vitin 2018 ka qenë 7,219.001 euro. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte rreth 99%.

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Rahovecit ka qenë 7,537,669 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se *shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve "Mallra e shërbime" nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat*. Në anën tjetër, sipas raportit auditimit për komunën e Rahovecit për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 7,559,595 euro ndërsa realizimi për vitin 2019 ka qenë 7,330,406 euro, apo shprehur në përqindje është realizuar prej 97%.

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Rahovecit ka qenë 7,650,376 euro. Në nenin 12 par. 6 të këtij Ligji është përcaktuar se *shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës*. Përderisa sipas raportit auditimit për komunën e Rahovecit për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2020 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 7,716,938.32 euro ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë 7,716,523.13 euro, apo shprehur në përqindje është realizuar prej 99%. ZKA ka konstatuar se buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 160,117€ kjo rritje ishte rezultat i angazhimit të stafit për pandeminë Covid -19.

Nga Ligjet përkatëse të cituara si më lartë, përkatësisht në raport me zërat për ndarje buxhetore, rezulton se Komuna e Rahovecit nuk ka ndarë asnjë linjë buxhetore për paga të 13-ta për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e në anën tjetër realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është realizuar

në atë masë sa nuk rezulton rezeve buxhetore për të mbuluar pagat e 13-ta për punonjësit, përkatësisht në rastin konkret paditëses.

Sa i përket pjesës së kërkesës për pagesën e pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022, gjykata konstaton se bazuar në faktin se Kontratës së lartcekur mbi bazën e së cilës pala paditëse e mbështetë themelësinë e kërkesëpadisë i ka skaduar afati i vlefshmërisë me dt.10.06.2021, rezulton se e njëjta ka pushuar të prodhojë efekt juridik. Në këtë kuptim, punëtorët shëndetësorë nuk mund t'i gëzojnë beneficionet e përcaktuara me dispozitat e kësaj Kontrate edhe pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së të njëjtës, përfshirë edhe të drejtën e kompensimit të pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022. Si rezultat i një interpretimi të tillë, Gjykata vlerëson se palës paditëse i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë në këtë çështje juridike, respektivisht mbështetja e bazës juridike në një akt juridik të cilit i ka skaduar afati i vlefshmërisë, paraqet fakt i cili është qartazi në kundërtënie me një fakt që Gjykata e konsideron të njohur. Bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të procedohet tutje me caktimin e seancës gjyqësore për tu vërtetuar faktet e pretenduara nga pala paditëse, për faktin se ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës në raport me themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi dhe arsyet si më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

-Lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës:

Gjykata pas vlerësimit të prapësimin material të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, ka konstatuar se kërkesa e paditëses është e përfshirë edhe në parashkrim për vitet 2018 dhe 2019, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e po ashtu pati parasysh edhe nenin 342 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Paditësja, padinë e ka paraqitur me datë 11.12.2023, e në qoftë se kërkesa për kompensimin e pagës së 13-të, do të kishte themelësi atëherë e njëjta do të kompensohej në fund të vitit 2018, e që nga fundi i vitit 2018 e deri me paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se 4 vite e gjysmë, ndërsa në llogaritje për kërkesën e pagës së 13-të, të vitit 2019, e njëjta do të kompensohej në fund të vitit 2019, pra pasi që padia është paraqitur me datë 11.12.2023, konstatohet se kanë kaluar më shumë se 3 vite e gjysmë.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 *“Secila palë paraprkishtë vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”*, e lidhur me nenin 463.1 *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm*

me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1413/2023, më datën 12.12.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.